



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	15.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHQYRTIMIC	7496/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1394/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1394/2023, të datës 08.11.2023, të parashtruar nga ankuesja dhe kundër organit të punësimit: Agjencia e Kosovare për Produkte Medicinale, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1394/2023, e datës 08.11.2023 e parashtruar nga ankueset

A r s y e t i m

Nëpunëset civile, dhe (tutje referuar vetëm ankueset), më datë 08.11.2023, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me shenjën A.Nr.1394/2023, me pretendimin ankimor së kategorizimi i tyre në nivelin profesional 1, është i pa drejtë sepse te njëjtat janë specialistë të lemive përkatëse Analizë dhe Kontroll të barnave, Farmaci Klinike dhe Mikrobiologji, dhe se mbi këtë bazë duhet të kategorizohen si specialiste të farmacisë më koeficient 12 të pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.12.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale. Kjo e fundit, më datë 21.11.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e parakohshme, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht sipas Aktit të Emërimit të datës 05.07.2017, ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë Shqyrtuese", në Departamentin e Autorizim Marketingut në kuadër të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale. Ndërsa, ankuesja Naime Morina sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 26.02.2013 është e punësuar në pozitën "Zyrtare e Lartë e Departamentit të Autorizim Marketingut", në kuadër të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale.

Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesja ka realizuar koeficient pesë (8) të pagës, sipas sistemit të vjetër të pagave, kurse, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në profesional 1, me koeficient të pagës 5.7. Ankuesja ka realizuar koeficient tetë (8) të pagës, sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është klasifikuar në profesional 1, me koeficient të pagës 5.7.

Ankueset dhe në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se sistemimi në klasën profesional 1 është i padrejtë, sepse të njëjtat janë specialiste të lemive përkatëse Analizë dhe Kontrol të Barnave, Farmaci Klinike dhe Mikrobiologji, ku duhet të kategorizohen si specialist të farmacisë me koeficient 12 të pagës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale, nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueseve në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës të tyre të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë (i aplikueshëm në këtë periudhë) dhe Rregullores(QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por, si rezultat i ekuivalencës së sistemit

të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023 dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueseve për kategorizimin në kategorinë specialistë të farmacisë, është e parakohshme dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritot. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankueseve do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tyre të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1394/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.